

LËVIZJET E SHTETASVE NË SHQIPËRI

Shkurt 2026

Gjatë muajit Shkurt 2026, rezultojnë të kenë hyrë, në territorin e Republikës së Shqipërisë, 1.100.681 shtetas shqiptarë dhe të huaj. Ky tregues ka pësuar një rritje me 3,9 %, krahasuar me Shkurt 2025.

Gjithashtu, 1.090.650 shtetas shqiptarë dhe të huaj, rezultojnë të kenë dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë, duke shënuar një rritje me 2,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Hyrjet në Shqipëri:

- Shtetas shqiptarë: 584.450 (rritje me 7,6 %)
- Shtetas të huaj: 516.231 (rritje me 0,03 %)


Daljet nga Shqipëria:

- Shtetas shqiptarë: 572.854 (rritje me 5,3 %)
- Shtetas të huaj: 517.796 (rënie me 1,0 %)

Rajonet e hyrjes së shtetasve të huaj:

- Evropa Jugore kontribuon me 85 % dhe Evropa Perëndimore me 5 % të hyrjeve nga Evropa.

FIG. 1 LËVIZJET E SHTETASVE NË SHQIPËRI, SHKURT 2025 - SHKURT 2026



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

TAB. 1 LËVIZJET E SHTETASVE SHQIPTARË DHE TË HUAJ

Periudha	Shkurt 2025	Shkurt 2026	Ndryshimi vjetor %	Janar-Shkurt 2025	Janar-Shkurt 2026	Ndryshimi vjetor %
Hyrje Gjithsej	1.059.274	1.100.681	3,9	2.217.475	2.297.231	3,6
Shqiptarë	543.216	584.450	7,6	1.141.024	1.228.813	7,7
Të Huaj	516.058	516.231	0,03	1.076.451	1.068.418	-0,7
Dalje Gjithsej	1.066.954	1.090.650	2,2	2.427.253	2.433.723	0,3
Shqiptarë	543.803	572.854	5,3	1.261.501	1.313.014	4,1
Të Huaj	523.151	517.796	-1,0	1.165.752	1.120.709	-3,9

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

TAB. 2 HYRJET E SHTETASVE TË HUAJ SIPAS RAJONIT

Periudha	Shkurt 2025	Shkurt 2026	Janar-Shkurt 2025	Janar-Shkurt 2026
Gjithsej	516.058	516.231	1.076.451	1.068.418
I . Afrika	1.913	2.426	3.129	3.802
II. Amerika	9.233	10.255	20.263	21.056
III. Azia Lindore dhe Paqësori	3.744	3.077	7.329	5.919
IV.Lindja e Mesme	1.037	981	2.030	1.951
V. Azia e Jugut	2.464	2.988	4.551	5.349
VI. Evropa	497.293	495.642	1.038.328	1.028.850
- Evropa Qëndrore / Lindore	21.121	18.633	40.669	35.191
- Evropa Veriore	19.677	19.333	34.713	33.552
- Evropa Jugore	413.957	421.258	885.352	891.328
- Evropa Perëndimore	27.963	23.919	47.644	43.088
- Evropa Lindore / Mesdheut	14.575	12.499	29.950	25.691
VII. Rajone të paspecifikuara	374	862	821	1.491

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Qëllimi i hyrjes në territorin shqiptar i shtetasve të huaj, në 96 % të rasteve është për qëllime personale. Në Shkurt 2026, ky tregues ka shënuar një rënie me 0,2 %, krahasuar me Shkurt 2025. Hyrjet e shtetasve të huaj, për qëllime biznesi dhe profesionale janë rritur me 7,9 %.

Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Lëvizjet e Shtetasve në Shqipëri](#), si dhe në seksionin e tabelave në website në temën: [Lëvizjet e Shtetasve](#)

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë). Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person, që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti, llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë). Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person, që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti, llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.
2. Trajtime shëndetësore
3. Qëllime fetare
4. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Departamenti për Kufirin dhe Migracionin).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi i vazhdueshëm. Për më shumë informacion referojuni:

https://www.instat.gov.al/media/2940/revision_policy_2016.pdf

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”. neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuark në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje.
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtare, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje.
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e shqiptarëve, të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.